



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKTORI I MBIKQYRJES SË TREGUT DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT

SEKTORI I MBIKQYRJES SE TREGUT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Është pjese e struktures se Drejtorisë së Bujqësisë dhe Ushqimit në Bashkinë Maliq dhe e kryen aktivitetin e saj , bazuar ne :

I-LIGJIN NR. 139/2015 , Dt. 17.12.2015, “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”

II-LIGJET DHE VKM-TE PER SHERBIMIN VETERINAR NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

- 1-Ligji Nr.10465,dt.29.09.2011-“Per sherbimin veterinar ne Republiken e Shqiperise”.
- 2-V.K.M.Nr.146,dt.13.03.2018-“Per krijimin,organizimin dhe funksionimin e Agjensive Rajonale te Sherbimit Veterinar dhe mbrojtjes se bimeve”.
- 3-Ligji Nr.9426,dt.06.10.2005, “Per mbareshtimin e blegtorise”,ndryshuar me Ligjin Nr.79/2018 dt.15.11.2018.
- 4-Ligji Nr.8702,dt.01.12.2000, “Per identifikimin dhe regjistrimin dhe identifikimin e kafsheve dhe te fermave blegtorale”,I ndryshuar me ligjin Nr.66/2013,dt.14.02.2013.
- 5-Ligji Nr.87/2012, “Per miratimin e Aktit Normativ,me fuqite e Ligjit Nr.4,dt.16.08.2012,te Keshillit te Ministrave “Per percaktimin e rregullave per therrien e kafsheve dhe te tregetit te mishit te tyre”.
- 6-V.K.M. Nr.230,dt.20.03.2013-“Per percaktimin e detyrave dhe funksioneve specifike te sherbimit veterinar te pushtetit lokal”.
- 7-V.K.M Nr.408,dt.08.05.2013-“Per demshperblim per kafshet e eleminuara”.
- 8-V.K.M Nr.957 dt.07.12.2016-“Per pagesen e kosos financiare te sistemit te identifikimit dhe te regjistrimit te kafsheve te fermave blegtorale nga fermeret”.
- 9-V.K.M Nr.72,dt.07.02.2018-“Per percaktimin e kriterave baze te sektoreve qe do te mbeshteten dhe te mases se financimit nga fondi I programit per bujqesine dhe zhvillimin rural,per vitin 2018”.

III-LIGJET DHE VKM-TE PER SIGURINË USHQIMORE

- 1-Ligji Nr.71/2018,dt.18.10.2018, “Per disa ndryshime dhe Shtesa ne Ligjin Nr.9902,dt.17.04.2008, “Per mbrojtjen e konsumatoreve”,i ndryshuar.
- 2-Ligji Nr.74/2013 dt.14.02.2013, “Per disa ndryshime dhe shtesa,ne ligjin Nr.9863,dt.28.01.2008 “Per Ushqimin”i ndryshuar.
- 3-Ligji Nr.10433,dt.16.06.2011, “Per inspektimin ne Republiken e Shqiperise”.
- 4-Ligji Nr.73/2013 dt.14.02.2013, “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr.9441,dt.11.11.2005, “Per prodhimin ,grumbullimin,perpunimin dhe tregetin e qumshetit dhe prodhimeve me baze qumeshtin”,i ndryshuar.
- 5-Ligji Nr.106/2016,dt.27.10.2016, “Per prodhimin biologjik,etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”.
- 6-Ligji Nr.10081,dt.23.02.2009, “Per licencat,autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise”.
- 7-Ligji Nr.9199,dt.26.02.2004, “Per prodhimin,perpunimin,certifikimin dhe tregetin e produkteve “BIO””.
- 8-V.K.M.Nr.1344,dt.10.10.2008, “Per miratimin e rregullave per etiketimin e produkteve ushqimore”.
- 9-V.K.M Nr.1081,dt.21.10.2009, “Per organizimin dhe funksionimin e AKU”.

10-V.K.M Nr.760 dt.16.09.2015, “Per kerkesat per gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit per kafshe pergjate zinxhirit ushqimor”.

MISIONI I PUNËS I SEKTORIT ËSHTË:

1. Sigurimi i nje niveli te larte te mbrojtjes se shendetit te njerezve dhe interesave te konsumatorit duke percaktuar dhe kontrolluar:
 - Kerkesat dhe parimet e pergjithshme per higjenen dhe sigurine e ushqimeve.
 - Detyrimet e operatoreve te biznesit ushqimor per higjenen dhe sigurine e ushqimeve
 - Kerkesat e pergjithshme per cilesine e ushqimeve
 - Kerkesat e pergjithshme per regjistrimin e treguesve gjeografike dhe emertimin e origjines se kontrolluar.
 - Kerkesat e pergjithshme per menyren e etiketimit te ushqimeve dhe ushqimeve per kafshet dhe afatet e perdorimit te ketyre ushqimeve.
 - Kerkesat e pergjithshme te nxjerrjes ne treg te ushqimeve dhe te ushqimeve per kafshe.
 - Kerkesat e pergjithshme per sigurimin e kushteve termike te ruajtjes se ushqimeve.
2. Mbrojtjen e interesave te konsumatoreve,duke sensibilizuar per te drejtat dhe detyrimet qe ata kane,si dhe duke mbledhur ankesat per shkeljen e te drejtave te konsumatoreve si dhe dergimin e tyre ne instancat me te larta per ti zgjidhur ato.
3. Mbrojtjen e shendetit public nga semundjet zoonotike te transmetueshme nga kafshet,si dhe lendet mbetese te demshme,te cilat gjenden ne produktet per konsum publik.

ARRITJA E OBJEKTIVAVE REALIZOHET NEPERMJET:

- 1-Ndarjes dhe percaktimit te detyrave specifike per cdo specialist te fushes ne sektor.
- 2-Bashkepunimin me inspektorët e Drejtorise Rajonale te AKU-se,per dhenien dhe marrjen e informacioneve te perbashketa sipas problematikave te hasura ne terren.
- 3- Bashkepunim me inspektorët e Agjensise Veterinare ne Korce,ne lidhje me masat profilaktike per gjurmimin dhe luftimin e semundjeve zoonotike te transmetueshme nga kafshet tek njerezit.
- 4-Konsultimi dhe ndihma e Titullarit te Bashkise per zgjidhjen e problematikave qe specialistet tane hasin,si dhe bashkepunimi me sektoret e tjere ne Bashki.
- 5-Konsultimi dhe bashkepunimi me konsumatorin e thjeshte dhe me shoqaten e mbrojtjes se konsumatorit per zgjidhjen e problematikave.

FUSHA E VEPRIMIT TE SEKTORIT TE MBIKQYRJES SE TREGUT DHE MBROJTJES SE

KONSUMATORIT KONSISTON NE:

- Kontrollin e subjekteve qe tregetojne mish dhe nenprodukte te tij.
- Kontrollin e subjekteve qe grumbullojne qumesht dhe perpunojne ate(baxho,punishte fabrika te perpunimit te qumshtit).
- Kontrollin e subjekteve qe tregetojne ushqime me origjine bimore dhe shtazore
- Kontrollin e fast-foodeve dhe qebaptoreve.
- Kontrollin e Bar-Restoranteve.
- Kontrollin e tregut ushqimor te hapur dhe ambulant
- Mbledhjen,grumbullimin,transportin dhe groposjen e kufomave dhe kadavrave te kafsheve te ngordhura ne vendet e caktuara per kete qellim.
- Disiplinimi dhe kontrolli i kafsheve te rruges(qenve endacake,pa pronar) dhe marrjen e masave per eliminimin e kafsheve agresive.

VEPRIMTARIA E KRYERË :

- Gjatë vitit 2018 , janë inspektuar 71 subjekte ushqimore , te cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre ne teritorin e Bashkise Maliq, në të gjitha Njësitë Administrative.
- Janë kontrolluar çdo jave tregjet e hapura abulante ne te gjitha Njesitë Administrative
- Jane bere takime ,sçarime dhe konsultime me gjithë blegtoret dhe fermeret , ne te gjitha Njesite Administrative, per ti nxitur ato qe te aplikojne per te perfituar nga skemat e subvencionimit nga Shteti dhe per te perfituar nga projektet e IPARD -2.
- Ju kemi ofruar blegtoreve dhe fermereve asistence teknike , per zbatimin e masave profilaktike ne kafshe , per permiresimin e kushteve sanitaro- veterinare te ambjenteve ku mbahen kafshet dhe per rritjen e pjellorise dhe rendimentit te kafsheve nepermjet permiresimit rracor dhe luftimit te semundjeve ne kafshe.
- Gjate muajit Janar 2019, jane inspektuar 10 subjekte ushqimore dhe jemi ne vazhdimesi te punes dhe per muajte ne vijim